




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot. 01-1083/14
Br. Prot. 01-1083/14
Prot No. 01-1083/14
Data 20.03.2014
Datum 20.03.2014
Date 20.03.2014
Nr. i faq. 02
Broj stranica 02
Nr. pages 02
PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Yll Gashi – Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Agjencionin kosovar për produkte medicinale
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Gashi

Lidhur me kërkesën e pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-887/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Lidhur me kërkesën tuaj, në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

Faqe 1 nga 1

OPINION :

Ekziston konflikt i mundshëm interesi për shkak se ekziston kufizim në ushtrimin e funksioneve publike si Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Agjencionin kosovar për produkte medicinale dhe punës si ekspert i licencuar i Prokurimit publik në kompani private (pretendente për të fituar projektin e Qeverisë së Kosovës për Sistemin elektronik të Prokurimit).

Arsyetim:

Ky kufizim në ushtrimin e funksionit publik del nga Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) i cili në nenin 16, paragrafi 1 e 2 që shprehimisht thonë:

1. "Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit".

2. "Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtroj veprimtari private, si: avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni".

Meqenëse ju vazhdoni të jeni zyrtar e lartë, atëherë ju rekomandojmë që gjithëmon të keni parasysh nenin 13 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në të cilin bëhet fjalë për Deklarimin "rast për rast" të interesave private të zyrtarit të lartë.

Në paragrafin 1 të këtij neni, shprehimisht thuhet:

"Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, "rast për rast", të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit".

Po ashtu edhe me Kodin e Etik në Prokurimin publik i cili duhet të respektohet nga të gjithë nëpunësit publik, në nenin 5 paragrafi 1 shprehimisht thuhet:

5.1 "Zyrtarët e prokurimit do të sillen në çdo kohë në pajtim me përgjegjësitë e postit të tyre dhe do të kenë kujdes të veçantë se sjellja e tyre nuk do të ketë efekt të dëmshëm për organizatën e tyre, që rrjedh nga konflikti mes interesave të tyre dhe interesave të organizatës".

Me respekt,

